

Një muslimane shtatzënë të cilën e kishin sulmuar disa antiismamistë në periferi të Parisit, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të mjekëve, u desh ta abortoj fëmijën e saj, njofton dailymail.

Kjo muslimane ishte në muajin e katërt të shtatzënisë kur u sulmua nga dy sulmues meshkuj. Sulmuesit fillimisht janë përpjekur t'ia largojnë shaminë e që pastaj t'ia prenë flokët dhe shqyejnë teshat.

Gruaja e pafajshme frikshëm bërtiti se është shtatzënë kur sulmuesit filluan ta shqelmonin në stomak. Pastaj ajo u dërguar në spital që mjekët t'ia sanonin plagët.

Siç raportojnë mediat e huaja, gruaja muslimane u përball me një sërë fyerjesh raciste të cilat janë të papranueshme në Francë./Shembulli/